



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

PA1 Nr.08-210

30.07.2024

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 80 paragrafi (5) nga Ligji i njëjtë, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), neni 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-210 datë 15.07.2024, për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-210 datë 29.07.2024, për miratimin e vendimit të heqjes së lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-3290/2 datë 29.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 31-të mbajtur më 29.07.2024 miratoi:

**VENDIM**

**për marrjen e lejes së radiotransmetimit të  
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar**

1. I HIQET leja për transmetim në radio, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës nr.2024-100-0151 datë 10.06.2024, (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024).

2. Fatura nr.2024-100-0151 datë 10.06.2024, (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024), anulohet dhe subjektit nga pika 1. e këtij Vendimi, i lëshohet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, respektivisht nga dita e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

3. Ky Vendim publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, është zotëruar i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal, për zonën e komunës së

Gostivarit, shërbim programor radiomuzikor – me fjalë me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për lejen e transmetimit televiziv ose radio transmetuesi, me përjashtim të shërbimit publik transmetues, paguajnë kompensim vjetor në llogari të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me Ligjin. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 të LSHMAAV).

Në lidhje me kompensimin për lejen e transmetimit në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nr.08-437 datë 15.08.2016, Agjencia më 10.06.2024, dërgoi Faturë me nr.2024-100-0151 datë 10.06.2024, (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024) për kompensim të lejes, në pajtim me të cilën transmetuesi ka pasur detyrim të paguajë shumën 30.770,00 (tridhjetë mijë e shtatëqin e shtatë dhjetë) denarë për kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio, për periudhën nga data 10.06.2024 deri më 09.06.2025. Fatura u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 12.06.2024.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryhen mbikëqyrje administrative, mbi punën e botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe dispozitave ligjore (neni 29 paragrafi 1 të LSHMAAV).

Agjencia, nëpërmjet Sektorit për financa dhe logjistikë, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor për lejen, dhe pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr ynë.ark.05-3047/1 datë 12.07.2024), është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të paraparë në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, respektivisht nuk e ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në llogari të Agjencisë.

Rrjedhimisht, sipas Faturës së dorëzuar nr.2024-100-0151 datë 10.06.2024 (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024), SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, kishte detyrim të paguajë 30.770,00 (tridhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) denarë për kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio për periudhën nga data 10.06.2024 deri më datë 09.06.2025, përfshirë këtu dhe datën 11.07.2024, si afat i fundit ligjor për pagesën e kompensimit SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 30.770,00 (tridhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) denarë.

Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV, është përcaktuar se nëse konstatohet mos respektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, miratuar në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, kundër botuesit të medias, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose transmetim në radio, para skadimit të afatit për të cilin është dhënë leja dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim, nëse zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin në afatin e përcaktuar ligjor.

Procedura për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose transmetim në radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e verifikuar faktike, sipas së cilës zotëruesi i lejes, SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, në afatin e parashikuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, respektivisht zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar ligjor, personi i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, në bazë të nenit 83 paragrafi (1), dhe në lidhje

me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, dorëzoi Propozim PA1 nr.08-210 datë 15.07.2024, për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 29-të, mbajtur më 17.07.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-3053/2 datë 18.07.2024, e miratoi Propozimin, PA1 nr.08-210 datë 15.07.2024, për inicimin e procedurës për marrjen e lejes së transmetimit të radios të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia i dërgoi Njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr.08-210 datë 18.07.2024), me të cilën i është treguar se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e kryerjes së transmetimit në radio në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për marrjen e lejes, PA1 nr.08-210 datë 15.07.2024, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, nga ku në pajtim me nenin 85 paragrafi (20) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.08-210 од 18.07.2024, është dorëzuar me shkrim me postë rekomanduese tek SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar dhe e njëjta është pranuar nga transmetuesi më 22.07.2024. Njëkohësisht, Agjencia më 26.07.2024, e ka dërguar shkresën dhe në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet (mbahet) nga Agjencia. Agjencia ka kryer kontroll dhe në sistemin elektronik – të përcjelljes së dërgesave të SH.A Posta e RMV-së, përmes së cilës kontrollon statusin e dërgesave dhe është konstatuar se shkresa i është dorëzuar në mënyrë të rregullt transmetuesit më 22.07.2024.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit, të fillojë procedurën për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin se zotëruesi i lejes SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, dhe në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-210 datë 15.07.2024, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk e ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, personi i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, dorëzoi Propozimin nr.08-210 datë 29.07.2024, sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-3290/2 datë 29.07.2024, miratoi Vendim me të cilën i hiqet leja, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, për shkak se zotëruesi i lejes nuk e përmbushi detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, respektivisht nuk e pagoi kompensimin për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar ligjor.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose transmetim në radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dorëzuar në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, e njëjta anulohet dhe i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, faturë e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj. Në të kundërtën pagesa e borxhit, do të kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, Fatura me nr.2024-100-0151 datë 10.06.2024 (nr ynë.ark.05-2680/1 datë 10.06.2024) për kompensimin e lejes për transmetim në radio, anulohet dhe SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, respektivisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për marrjen e lejes dhe duhet të pagohet jo më vonë se dita e 8 (tetë) nga dita e dhënies së saj.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, Vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio është përfundimtar, ndërkaq kundër tij, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtojë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, ka të drejtë padie për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të tij.